



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1978, datë 14.06.2012

Për

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1881, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e akses origjinimit (OSHKP) midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 14.06.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbyllja e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1881, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e akses origjinimit (OSHKP) midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”,

të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (*Raporti*);

- Projekt Vendim i KD (*Projekt Akti*);
- Dokumentet shkresore të palëve (*Provat, Pretendimet*);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimin nr. 1881, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e akses origjinimit (OSHKP) midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”,
- Shkresë e Neofone sh.p.k. me nr. 156Prot., datë 3.5.2012, “Parashtrime përfundimtare për VKD nr. 1881, datë 19.4.2012”;
- Shkresë e AMC me nr. 147/8, dt. 10.5.2012, (nr. 416/5Prot i AKEP, datë 11.5.2012) “Mbi vendimin nr. 1881, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e akses origjinimit (OSHKP) midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.””
- Korrespondenca me postë elektronike e shkëmbyer mes palëve, si edhe
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. AKEP me anë të Vendimit nr. 1881, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e akses origjinimit (OSHKP) midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:

- “Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a”.
- Të njoftohen palët e interesuara sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;
- Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit;

II. Neofone sh.p.k., me shkresën nr. 156Prot., datë 3.5.2012, “*Parashtrime përfundimtare për VKD nr. 1881, datë 19.4.2012*”, sqaron se:

1. Neofone sh.p.k., bazuar në kuadrin rregullator i ka dërguar disa kërkesa rradhazi operatorit Albanian Mobile Communication sh.a. në lidhje me implementimin dhe firmosjen e aneksit përkatës për shërbimin e akses origjinimit. Neofone sh.p.k. ka paraqitur kërkesat me nr. 59Prot., datë 11.1.2011, nr. 88Prot., datë 2.6.2011 dhe 103Prot., datë 6.9.2011, kjo e fundit për tejkalimin e afateve ligjore në lidhje me kërkesën e Neofone për ofrimin e shërbimit të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve drejt numrave me kartë të parapaguar (OSHKP);

Neofone sqaron se, ofrimi i këtij shërbimi do të ketë ndikim në:

- Krijimin e konkurrencës në tregun e akses origjinimit, treg i cili aktualisht është monopol i FNT, në kushtet ku zgjedhja/parazgjedhja e bartësit nuk është implementuar ende;
- Ofrimin e një shërbimi të plotë nga Neofone për tregun shqiptar pasi operatori AMC dicka me shumë se 35% të tregut të telefonisë mobile;
- Vonesat e krijuara nga AMC ndikojnë drejtpërdrejtë financiarisht tek të ardhurat dhe investimet e Neofone duke krijuar kosto financiare, që përbejnë një dëm të konsiderueshëm financiar.
- Uljen e tarifave, pasi ato të ofruara nga OFNT - AMC janë shumë të larta etj.

Neofone, shpjegon se moslidhja e MI, sjell:

- humbje të konsiderueshme financiare për të pasi nuk mund të aksesohet nga abonentet e AMC që dëshirojnë të përdorin shërbimet e ofruara nga Neofone, duke moslejuar konkurrencën dhe zgjedhjen e lire në shërbime;
- nuk lejon liberalizimin e tregut të akses-origjinimit të trafikut nga abonentët e AMC drejt rrjetit të Neofone;
- abonentët e AMC e cila vazhdon të ofrojë tarifa shumë të larta pasi ata nuk kanë asnjë mënyrë tjetër aksesit për shërbimet e ofruara nga Neofone me cmime shume të lira se sa OFNT-AMC.

Neofone sh.p.k. i kërkon Këshillit Drejtues të AKEP:

1. Të dalë me një urdhër të posaçëm, në zbatim të nenit 60, të ligjit nr. 9918, duke e urdhëruar AMC sh.a. të implementojë në mënyrë të menjëhershme

amendimin për marrëveshjen e interkoneksionit dhe ofrimin e shërbimit të akses origjinimit për operatorin Neofone sh.p.k.

2. Të përcaktojë në mënyrë eksplicite një afat kohor ligjor brenda të cilit AMC sh.a. të përmbushë detyrimet ligjore për implementimin juridik të amendimit të marrëveshjes së interkoneksionit, alokimit të kapaciteteve fizike, si dhe implementimin teknik për ofrimin e shërbimit të akses-origjinimit drejt operatorit Neofone sh.p.k.

- III. AMC sh.a., me shkresën nr. 147/8, dt. 10.5.2012, (nr. 416/5Prot i AKEP, datë 11.5.2012) *“Mbi vendimin nr. 1881, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e akses origjinimit (OSHKP) midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.””*.

AMC me këtë shkresë bën me dije se problemi i MI për shërbimin e akses origjinimit (OSHKP) midis sipërmarrësve Neofone dhe AMC, është në proces. AMC ka përgatitur draftin e amendamentit të kontratës kryesore dhe ia ka komunikuar Neofone, i cili ka bërë plotësime dhe është në fazën e fundit për nënshkrim.

Në të njëjtën kohë stafi i AMC ka filluar filluar punë për implementimin e shërbimit të akses origjinimit midis AMC dhe Neofone.

Gjatë këtij procesi janë hasur probleme për implementimin e këtij shërbimi si dhe në sistemin e billingut, duke qenë se është hera e parë që AMC implemton një shërbim të tillë.

AMC po vazhdon punën për mbarimin e implementimit të shërbimit të aksesit sa më shpejt të jetë e mundur.

- IV. Kërkesa e sipërmarrësit Neofone sa më sipër, referohet në qëndrimet rregullatore të AKEP-it të vendosura nëpërmjet akteve normative dhe individuale administrative konkretisht për rastin, të materializuara në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg AMC sh.a.

AKEP gjen me vend dhe të arsyetuar kërkesën e Neofone sh.p.k për ofrimin e shërbimit të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve drejt numrave të ofruesve të thirrjeve me karta të parapaguara (OSHKP), dhe njëkohesisht konstaton kohë vonese proceduriale të sipërmarrësit AMC sh.a. në realizim e kërkesës së Neofone sh.p.k për përfitimin e shërbimit mbështetur në përcaktimet e dokumentit bazë të rregullimit të marrëdhënieve të tyre të ofrim-përfitim shërbimit që është RIO e AMC sh.a. e përditësuar me VKD nr. Nr. 1932, datë 07. 5.2012 Për “Disa korrigjime në VKD nr. 1883, datë 19. 04. 2012 të AKEP “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Albanian Mobile Communication Sh.A”.

AKEP konstaton gjithashtu, se arsyetimi i operatorit ofrues AMC sh.a, *(i cili është paraqitur jashtë afatit procedural të vendosur nga AKEP)* për ofrimin e shërbimit të aksesit - origjinimit nuk përbën në thelb një arsyetim gjithëpërfshirës të shkaqeve të refuzimit dhe nuk ka të specifikuar afatin kohor të saktë, se kur do të përmbushet kërkesa e Operatorit Përfitues Neofone sh.p.k..

AMC sh.a. duhet të garantojë se marrëveshja e ofrimit të akses origjinimit mes këtyre dy palëve, apo një amendament i mundshëm mes tyre i kontratave të lidhura dhe në fuqi, duhet të mbështetet në detyrimet ligjore dhe kushtet aktuale të tregut të komunikimeve elektronike, duke reflektuar të gjitha shtesat dhe ndryshimet e bëra në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të kësaj shoqërie në mënyrë të menjëherëshme.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1881, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e akses origjinimit (OSHKP) midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”.
2. AMC sh.a dhe Neofone sh.p.k të lidhin MI për ofrimin e shërbimit të akses origjinimit sipas Urdhërit të AKEP bashkëngjitur këtij Vendimi.
3. Të njoftohen palët e interesuara Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a., për mbylljen e procedimit administrativ;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

U R D H Ë R

Nr. , datë 14.06.2012

Për

“Lidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit midis Albanian Mobile Communications sh.a, dhe Neofone sh.p.k.”

Në mbështetje të nenit 60 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullore Nr. 18, date 11.06.2010, “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, Rregullore Nr. 19, datë 14.06.2010, “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar, VKD nr.1373, datë 10.09.2010, “Për mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1881, datë 19.04.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Neofone sh.p.k.””.

U R D H Ë R O J:

1. Albanian Mobile Communications sh.a. të lidhë Marrëveshje Interkoneksioni (MI) me Neofone sh.p.k. ose Amendament të MI aktuale, për përfshirjen e shërbimeve të akses origjinimit në rrjetet e të dy operatorëve brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit të këtij Urdhëri.
2. Palët të depozitojnë në AKEP një kopje të Marrëveshjes së Interkoneksionit apo Amendamentit të nënshkruar nga palët brenda 5 (pesë) ditëve nga data e nënshkrimit të saj;

3. Moszbatimi i këtij urdhëri përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas parashikimeve të nenit 137 të ligjit nr. 9918 date 19.05.2008.

Ky Urdhër hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE